



SHK 2021



TITUJT

Editorial: Për digitaizimin [faqja 1](#)

KOVID-19: Aktivitetet e përgjigjes dhe rimëkëmbjes nga KOVID-19 [faqja 2](#)

Korniza financiare e KBZhQ-së [faqja 3](#)

Në fokus: Përgatitja për vaksinat për KOVID-19 [faqja 4](#)

NGJARJET MË TË RËNDËSISHME

JAN- SHK

26 - UNODC zhvilloi një takim me drejtorin e ri të Drejtorisë së Doganave dhe një takim tjetër me drejtorin e Byrosë për Siguri Publike të Maqedonisë së Veriut. Të dy takimet ishin pas nënshkrimit të Marrëveshjes për krijimin e bashkëpunimit për kontrollin e kufirit në vend në kuadër të veprimit të përbashkët BE-UNODC, të financuar nga Bashkimi Evropian

28-11 - UNHRC në Maqedoninë e Veriut zhvilloi tre sesione për ndërtim të kapaciteteve në mbështetje të zbatimit të Strategjisë së komunikimit për ndryshim shoqëror, të prezantuar nga profesorë të Universitetit të Kentakit. Në këto sesione morën pjesë specialistë të komunikimit nga OKB-ja si dhe nga organizata dhe institucione tjera, duke përfshirë edhe personelin e UNHCR-së dhe të partnerëve të saj.

SHKURT

17-19 - Një tryezë e rumbullakët me Policinë kufitare dhe gjyqësorin u organizua në Gjevgjeli, në lidhje me qasjen në sistemin e azilit, parimin e mosndëshkimit dhe ndalimin e azilkerkuesve, si vazhdim i evenimentit të organizuar nga UNHCR-ja dhe Policia kufitare në shtator të vitit 2020..

18-19 - 13 anëtarë të OShC-ve të Platformës së barazisë gjinore morën pjesë në një trajnim për monitorimin e Planit nacional të veprimit 2018-2023 për zbatimin e Konventës së Stambollit. Trajnimi u organizua nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të programit rajonal të UN Women/BE EVAW "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve".

24 - Punëtori në internet mbi Ligjin e ri për zhvillimin e balancuar rajonal dhe Programin për zhvillim dhe decentralizim të qëndrueshëm lokal 2021-2023 (pjesë e veprimtarisë së UNDP-MPPS "Zgjidhje Inovative për një Qasje më të Mirë në Shërbimet Lokale")

EDITORIAL Koordinator i përhershëm i OKB-së

Ndonëse nga njëra anë është ende vështirë të kuptohen plotësisht humbjet tragjike të jetëve dhe ndikimi i gjerë negativ shëndetësor dhe socio-ekonomik i shkakuar nga KOVID-19, nga ana tjetër janë shfaqur mundësitë për rikuperim më të mirë. Një mundësi e tillë është potenciali i transformimit digjital të ekonomisë dhe shoqërisë, i cili do të kërkojë investime përmes së cilave do të përfitojnë të gjitha segmentet e shoqërisë dhe veçanërisht ato që ka të ngjarë që të lihen pas.

Mekanizmat digjitale – modaliteti i punës nga shtëpia, blerja nga interneti i shërbimeve dhe mallrave, shërbimet publike onlajn e të ngjashme, kanë qenë thelbësore për minimizimin e rrezikut të përhapjes së KOVID-19. Nëse disa biznese kanë pasur vështirësi në fillim të pandemisë për shkak të zvogëlimit të numrit të vizitorëve, tani ato mund të lulëzojnë për shkak të aftësisë së tyre për ta përshtatur dhe rregulluar veprimtarinë në internet në mënyrë të shpejtë dhe efikase. Megjithatë disa biznese vazhdojnë të përballen me vështirësi, për shkak të vonësës së transformimit të tyre digjital.

Digjitalizimi është me rëndësi thelbësore për ndërtim të serishëm dhe të përmirësuar, pasi ofron dhe kontribuon në procesin e efikasitetit, e përmirëson qasjen – në veçanti qasjen në shërbime publike dhe e zvogëlon koston në planin afatmesëm dhe afatgjatë.

Maqedonia e Veriut ka shënuar progres të konsiderueshëm në këtë drejtim dhe në vazhdimësi përfiton nga investimet e bëra dhe përshtatjet institucionale, duke përfshirë themelimin e Këshillit për Teknologji Informatike dhe Kompjuterike (TIK), Strategjinë për të Dhëna të Hapura, investimet në avancimin e shkathtësisë digjitale, përfshirjen e TIK trajnimit në të gjitha modalitetet arsimore etj.

Sidoqoftë ekzistojnë disa sfida, të cilat kërkojnë përpjekje të shtuar:

1. Pabarazitë vazhdojnë, andaj është detyra jonë e përbashkët t'i trajtojmë ato dhe të bëjmë gjithnjë e më shumë përpjekje për ta integruar plotësisht çdo anëtar të shoqërisë sonë në botën digjitale. Adresimi i pabarazive është me rëndësi thelbësore për arritjen e plotë të potencialit të digjitalizimit për një zhvillim të qëndrueshëm. Për shembull, qasja në arsimin përmes internetit është ende problem për një grup të fëmijëve. Pabarazitë e ngjashme vazhdojnë në raport me mundësinë

për qasje në shërbime shëndetësore.

2. Mundësia e përdorimit të gjerë dhe infrastruktura adekuate e TIK-së janë parakushte për ta siguruar digjitalizimin e proceseve dhe shërbimeve në të gjithë sektorët e shoqërisë. Për shembull, në zonat rurale, solucionet digjitale mund të përdoren në proceset bujqësore, mirëpo në Maqedoninë e Veriut ka ende zona gjeografike të cilat nuk kanë qasje adekuate në infrastrukturën e TIK-së.

3. Siguria në internet dhe siguria kibernetike - duhet të krijojmë një mjedis të sigurt, ku të gjithë do të kenë mundësi të zhvillohen në mënyrë të mirëfilltë. Duke filluar nga ngacimi në internet deri te mbrojtja e të dhënave dhe sistemeve vitale. Siguria është me rëndësi thelbësore për përdorimin në rritje dhe të përmirësuar të mjeteve dhe shërbimeve digjitale.

4. Roli i sistemit arsimor në procesin e digjitalizimit: nxënësit e sotëm duhet të jenë të përgatitur për botën e nesërme. Për ta bërë këtë, duhet t'u sigurojmë që infrastruktura e TIK-së të jetë në dispozicion për të gjithë, ndërsa ata të kenë aftësi të duhura për t'i përdor ato për përfitimet e tyre. Rreth 80% e familjeve në Maqedoninë e Veriut kanë qasje në internet, përsëri ky numër e lë prapa një të pestën e familjeve dhe fëmijëve të tyre. Qeveria ka bërë hapa të rëndësishëm duke rritur përfshirjen e trajnimit të TIK në të gjitha segmentet e arsimit, por ne duhet të sigurohemi që zhvillimi i aftësive digjitale të jetë i disponueshëm dhe prioritet për të gjithë.

Duke i zgjidhur këto sfida, do të krijojmë kushtet që digjitalizimi ta përshpejtojë transformimin e sistemit dhe t'i nxit reformat, duke shpjerë përfundimisht në një jetë më të mirë për të gjithë.

Rosana Duxhak
Koordinator i Përhershëm i OKB-së në Maqedoninë e Veriut



AKTIVITETET E PËRGGJIGJES DHE RIMËKËMBJES NGA KOVID-19

Agjencitë e OKB vazhdojnë t'i mbështesin masat për përgjigje ndaj KOVID-19 në vend, përmes analizave specifike dhe të hollësishme të përqendruara në çështje brenda fushave të tyre përkatëse të ekspertizës.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) e ka mbështetur analizën e ndikimit të pandemisë KOVID-19 dhe masat përkatëse të përgjigjes në lidhje me financimin e njëjësive të vetëqeverisjes lokale (NVL). Analiza tregon se situata në nivelin lokal është përkeqësuar ndjeshëm në tremujorin e dytë të vitit 2020, kur rritja e të ardhurave, në krahasim me të njëjtën periudhë në vitin 2019, ka qenë vetëm 1.8%, krahasuar me 11.8% në tremujorin e parë. Për dallim nga kjo, në të njëjtën periudhë, komunat urbane kanë shënuar një rënie prej 2.2% të të ardhurave për shkak të ndikimit më të theksuar të përgjigjes ndaj KOVID-19 në zonat urbane.

Kjo është rezultati i uljes së konsiderueshme të taksave të mbledhura në nivelin komunal, kryesisht nga tatimi në pronë, i cili ka rënë për 19.14% në tremujorin e dytë. Të ardhurat e vetme që vazhdimisht janë rritur dhe kanë qenë në proporcion të kundërt me rënien e përgjithshme kanë qenë transferimet nga pushteti qendror, me 27.48% rritje në tremujorin e parë dhe 20.25% rritje në tremujorin e dytë në vitin 2020 në raport me vitin 2019. Sidoqoftë, këtyre transferimeve (bllok dotacione) iu mungon fleksibiliteti, andaj edhe cenohet niveli i decentralizimit fiskal, duke i bërë komunat vazhdimisht të varura nga qeveria dhe buxheti qendror.

Në të njëjtën kohë shpenzimet komunale kanë rënë mesatarisht për 17.8%, me 28% rënie në zonat urbane, krahasuar me rritjen pothuajse të sheshtë në tremujorin e parë, duke sugjeruar që politikën e konsolidimit të iniciuar nga komunat kanë pasur ndikim të fortë në përmasën e shërbimeve të ofruara. Një nga kategoritë e pakta të shpenzimeve komunale që janë rritur ndjeshëm kanë qenë subvencionet publike.

Njëri ndër rekomandimet kryesore të bazuara në këtë hulumtim është sigurimi i decentralizimit fiskal të avancuar, përmes: (1) sigurimit të fondeve të mjaftueshme për kompetencat lokale duke reformuar sistemin e transferimeve fiskale, (2) përmirësimit të menaxhimit të financave publike (MFP) dhe kapacitetit administrativ në nivelin lokal, (3) rritjes së transparencës dhe llogaridhënies fiskale, dhe (4) përfundimit të rregullave të reja fiskale me fokus në disiplinën fiskale dhe qëndrueshmërinë fiskale në komuna gjatë rënies ekonomike/sociale.

Hulumtimi në fjalë zbulon një koordinim dhe komunikim horizontal dhe vertikal në nivelin komunal, përmes rolit të organeve efikase, efektive dhe transparente të komunave për menaxhim të krizave, ndonjëse pjesërisht më pak të suksesshme në ndarjen e praktikave më të mira dhe sigurimin e pjesëmarrjes së institucioneve lokale si shkollat, kopshtet, qendrat ditore dhe institucionet e kulturës. Mangësitë e sistemit të menaxhimit të

krizës lidhen kryesisht me boshllëqet ligjore për krijimin dhe funksionimin e selisë së komunave, mungesën e një kornize të qëndrueshme për rikuperim nga katastrofat natyrore dhe ato të shkaktuara nga njerëzit, si dhe nga dyfishimi i herëpashershme i kompetencave midis sistemit për menaxhim të krizave dhe atij për mbrojtje dhe shpëtim.

Për sa iu përket shërbimeve, shërbimet komunale ngelën të pandërprera, ndërsa vullnetarët arritën të shënojnë rezultate të shkëlqyeshme në saje të pakove humanitare, gjë që e potencon nevojën e rregullimit më të mirë të punës së vullnetarëve dhe avancimit të integritimit në suaza të sistemit për menaxhim të krizave. Njëra ndër sfidat e shërbimeve komunale përfshinte protokolle të punës në çerdhe, kopshte dhe qendra ditore. Komunat në përgjithësi nuk janë të përfshira në adresimin e sfidave, që ndërlihen me rritjen e incidenteve të dhunës në familje, duke i lënë këto çështje në dorë stacioneve policore dhe qendrave ndërkomunale për punë sociale. Në fushën e arsimit, komunat i kanë ndjekur rregulloret shtetërore për mësim nga distanca, ku mungesa e internetit, e pajisjeve dhe aftësive digjitale janë veçuar si sfidat kryesore për nxënësit, prindërit dhe arsimtarët.

UNHCR-ja ka ofruar mbështetje për autoritetet në Qendrën e Përkohshme të Transitit në Vinojog me azhurnimin dhe mirëmbajtjen e softuerit të skanerit Rapiscan dhe trajnimin e personelit që e përdor atë. Kjo ka mundësuar rifillimin e regjistrimit biometrik të të gjithë individëve të kapur në lëvizje të përzier nga autoritetet kufitare, që u pezullua që nga marsi i vitit 2020 për shkak të KOVID-19.

AKTIVITETE TJERA

Njëzet e shtatë gazetarë nga mediat nacionale dhe lokale të lajmeve morën pjesë në tre trajnime njëditore dhe i fuqizuan kapacitetet e tyre mbi "Raportimin e ndjeshëm ndaj gjinisë dhe rolit e gazetarëve në eliminimin e dhunës mbi bazë gjinore". Trajnimi është organizuar nga një organizatë partnere e UN Women, "Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë së Veriut", si pjesë e programit rajonal të UN Women-EU, që i jep fund dhunës ndaj grave "Zbatimi i Normave, Ndryshimi i Mendjeve".

UN Women e vazhdoi partneritetin me Ambasadën e Francës në Maqedoninë e Veriut dhe diskutoi mbi aktivitetet e përbashkëta në dritën e Forumit të "Brezit të Përkushtuar për Barazi", një tubim global për barazinë gjinore, i thirrur nga UN Women dhe i bashkëdrejtuar nga qeveritë e Meksikës dhe Francës (Meksiko Siti, 29-31 mars 2021). Franca dhe Maqedonia e Veriut janë pjesë e të njëjtë Koalicioneve të veprimit për të drejtat e autonomisë trupore dhe shëndetit seksual.

UNDP e ka hapur qendrën e burimeve rinore iCan në Gostivar, e themeluar me qëllim të inkurajimit të të rinjve të angazhohen në inovacion dhe sipërmarrje, t'i mbështesin idetë për digjitalizim dhe gjelbërim, t'i ndihmojë të rinjtë t'i zhvillojnë aftësitë e nevojshme për tregun e punës dhe t'i ndihmojnë ata të ndërtojnë një karrierë në komunitetin e tyre. Qendra menaxhohet nga Universiteti i Evropës Juglindore (UEJL) në partneritet me Komunën e Gostivarit; projekti i UNDP zbatohet me mbështetjen e Agjencisë Zvicëranë për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Mbledhja e parë e Këshillit Drejtues (KD) të Projektit të Përbashkët "Planifikimi i politikës dhe diskursit të migracionit të bazuar në prova në Maqedoninë e Veriut" është zhvilluar më 10 shkurt 2021 me 23 anëtarë të KD-së nga institucionet nacionale, organizatat e shoqërisë civile, IOM, UNFPA, UNHCR dhe Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së.

Mbledhja është hapur nga Ndihmësmministri për Bashkim Evropian dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Koordinatorit të Përhershëm i Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut. Përfaqësuesi

i Ministrisë së Punëve të Brendshme shprehu mirënjohje për mbështetjen që e ofron sistemi i OKB-së për institucionet nacionale dhe kontributin e tyre në procesin e reformave në vend. Ai theksoi se flukset e migracionit kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave dhe diskursit të migracionit, kurse mungesa e të dhënave të bazuara në prova është një nga sfidat kryesore të identifikuar në dokumentet strategjike nacionale, përfshirë Rezolutën e mëparshme mbi Politikën e Migracionit. Në këtë drejtim, ai theksoi se MPB-ja do ta mbështesë plotësisht zbatimin e aktivitetëve të projektit, i cili do të kontribuojë në tejkalimin e sfidave të identikuara dhe do të mundësojë krijimin e një politike të migracionit të bazuar në prova.

Koordinatori i Përhershëm i OKB-së e theksoi qëndrimin e OKB në menaxhimin e migracionit dhe nevojën për zhvillimin e një politike të re. Ajo shpjegoi që projekti do ta mbështesë zhvillimin e një politike mbi migracionin, që do të jetë parashikuese, e bazuar në prova dhe do t'i fuqizojë kapacitetet institucionale, duke krijuar një Indeks të migracionit, Profil të migracionit dhe prezantimin e modulit të migracionit në studimin e fuqisë së punës, si dhe përmes përdorimit të përmbledhjes së të dhënave inovative dhe mjeteve të analizës (të dhëna të mëdha). Koordinatorin i Përhershëm gjithashtu theksoi se mbështetja nga të gjithë partnerët e përfshirë në projekt është thelbësore për arritjen e rezultateve të pritura, veçanërisht për krijimin e politikave vizionare të migracionit dhe të bazuara në prova, që do të ndihmojnë në pozicionimin e vendit si një shembull rajonal dhe global në këtë fushë. Koordinatorin i Programit të Përbashkët të IOM-it, së bashku me anëtarët e ekipit të UNFPA-s dhe UNHCR-së e prezantuan qëllimin kryesor të projektit, që është kontributi në menaxhimin efektiv demografik dhe dinamikave të migracionit përmes zhvillimit të politikave përkatëse të bazuar në prova. Po ashtu e shpalosi një prezantim të shkurtër të komponentëve të projektit. Takimi i parë i KD-së u shfrytëzua gjithashtu për t'i prezantuar aktivitetet e planifikuara për vitin 2021 sipas Planit të Punës së projektit.

Përparimi i përsheptuar i njerëzimit gjatë dy dekadave të fundit ka sjellë një rritje të shpejtësisë, dinamikës dhe kompleksitetit të sfidave të zhvillimit të sotëm, duke rezultuar në një hendek midis praktikës ekzistuese të zhvillimit dhe ritmit të ndryshimit. Në vitin 2019, UNDP vendosi të tejkalojë këtë hendek duke krijuar përnjëherë 60 laboratorë përsheptues. Një vit më vonë falë mbështetjes së Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë, Fondi të Katarit për Zhvillim dhe partnerëve themelorë të UNDP-së, UNDP-ja është duke hapur 32 laboratorë të rinj përsheptues. Rrjeti më i madh dhe më i shpejtë i të mësuarit mbi sfidat e zhvillimit tani mbulon 116 vende.


Një nga shtesat më të fundit në rrjet është Laboratori i përsheptuesit në zyrën e UNDP-së në Shkup, Maqedoninë e Veriut. Ekipi i ri i Laboratorit përsheptues do t'i mbështesë përpjekjet e UNDP-së për ta përsheptuar progresin drejt Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke krijuar inteligjencë vepruese, zgjidhjen e hartave dhe zhvillimin e portofolit të eksperimenteve, që do të ndihmojnë në trajtimin e sfidave të zhvillimit të vendit në mënyra të reja dhe kreative.

Në vitin 2021 Laboratori përsheptues i UNDP në Maqedoninë e Veriut do të përqendrohet në iniciativën të dizajnuarë për ta katalizuar transformimin e sistemit dhe për t'i përsheptuar reformat në sektorin publik, duke i avancuar praktikën e qeverisjes së mirë, të bazuar në një qasje "të tërë shoqërisë". Laboratori gjithashtu do ta mbështesë vendin për ta trajtuar çështjen e vendeve të ardhshme të punës dhe duke punuar me Qytetin e Shkupit, kryeqytetin e vendit, me qëllim të zhvillimit të një portofoli intervenimesh për t'i trajtuar sfidat kryesore të zhvillimit.

LATEST EPIDEMIOLOGICAL DATA (8 Mar 2021)

106,832 CONFIRMED COVID-19 CASES
5,127 CONFIRMED CASES PER 100,000 PEOPLE
3,185 COVID-19 RELATED FATALITIES
152 FATALITIES PER 100,000 PEOPLE

Daily new cases reported



For latest data see covid19.who.int/region/euro/country/mk

KBZhQ 2021-2025 gasja tek resurset dhe Korniza e financimit

Çka është Korniza e financimit?

Kornizat e Bashkëpunimit të OKB për Zhvillim të Qëndrueshëm (KBZhQ) për Maqedoninë e Veriut 2021-2025 është dokumenti kryesor strategjik që udhëheq punën e Sistemit të OKB në vend. Ajo shoqërohet nga Korniza e Financimit KBZhQ, që e përshkruan koston e përgjithshme të arritjes së rezultateve të KBZhQ-së si dhe një pamje të situatës së financimit të KBZhQ-së. Korniza e Financimit ofron ndarje të hollësishme në vite, sipas rezultatit dhe prodhimit, sipas burimit të financimit dhe modalitetit të financimit, dhe sipas disponueshmërisë së fondeve.

Qëllimi kryesor i Kornizës së Financimit është ta risë transparencën e informacionit financiar në lidhje me punën e OKB-së në vend, si dhe të shërbejë si një mjet për planifikim financiar, menaxhim dhe mobilizim të burimeve. Si një referencë dhe përmbledhje e vetme e standardizuar e situatës së financimit të KBZhQ-së, korniza në fjalë synon të sigurojë një bazë për dialog mbi këto çështje midis OKB-së, qeverive dhe partnerëve tjerë të zhvillimit dhe si një kornizë për rritjen e koherencës së sistemit të OKB-së dhe mbivendosjen e zvogëluar në mobilizimin dhe menaxhimin e burimeve. Ajo gjithashtu e mbështet OKB-në me qasjen e koordinuar dhe të përbashkët për mobilizimin e burimeve dhe identifikimin e instrumenteve në dispozicion, duke përcaktuar dhe monitoruar boshllëkun e financimit.

Korniza e Financimit të Maqedonisë së Veriut është zhvillua midis nëntorit të vitit 2020 dhe shkurtit të vitit 2021. Njashthu është miratuar së fundmi nga Këshilli i Përbashkët Drejtues mes Qeverisë dhe OKB-së. Vlerësimet e kosos në Kornizën e Financimit kryesisht e mbulojnë periudhën pesëvjeçare të KBZhQ-së, bazuar në të dhënat financiare dhe vlerësimet nga të gjitha 18 agjencitë e OKB-së, nënshkruese të KBZhQ-së.

2021-2025 gjithsej resurse në dispozicion

Kërkesa e përgjithshme e parashikuar për financim për arritjet e KBZhQ-së gjatë pesë viteve është 178.2 milion dollarë amerikan, me një përzierje të ekuilibruar të fondeve në dispozicion dhe atyre që do të sigurohen. Për pesë vitet e plota në dispozicion janë 36% të fondeve të nevojshme, ndërsa 64% pritet që të sigurohen. Vlerësuar nga vitit i parë i implementimit, shumica e fondeve është tashmë në dispozicion, me vetëm 28% ose 13.8 milion ende ngelet që të sigurohen.

Nevojat e financimit sipas rezultateve të Kornizës së bashkëpunimit

Nga rezultatet e KBZhQ-së, Mjedisi i Shëndetshëm është më intensiv për sa u përket burimeve, me rreth gjysmën e vlerës së përgjithshme të fondeve (46% ose 83.8 milion dollarë) të nevojshme për përbushje të këtij rezultati, pasuar nga Qeverisja e Mirë, që kërkon rreth 24% (ose 43.6 milion dollarë) të fondit të përgjithshëm, gjegjësisht Prosperiteti Gjithëpërfshirës dhe Shërbime Cilësore për të Gjithë me rreth 14% të kërkesës së përgjithshme për secilin (përkatesisht 25.5 milion dollarë dhe 25.2 milion dollarë). Kjo është në përputhje me natyrën më intensive të burimeve për aktivitetet e nevojshme për t'i adresuar sfidat mjedisore, siç janë pastrimet komplekse të përbërjeve të rrezikshme kimike, investimet e rëndësishme në infrastrukturën e menaxhimit të përmbytjeve, instrumente të konsiderueshëm të financave të gjelbra, etj. Për sa i përket statusit të financimit, mjetet financiare për Rezultatit 3 kryesisht mbeten për t'u siguruar (69%), ndërsa një pjesë më e ulët por ende e konsiderueshme e financimit ngel për t'u siguruar për Rezultatet 1, 2 dhe 4 me 65%, 59%, përkatësisht 56%.





Nevojat sipas organizatave të familjes së OKB-së

Madhësia e kërkesave financiare të njësjive ekonomike ndryshon ndjeshëm në përputhje me aktivitetet dhe mandatet e tyre të ndryshme. Aktivitetet e parashikuara nga UNDP, UNOPS dhe UNICEF kërkojnë financim të mbi 10 milion dollarë për agjenci. FAO, UNEP, UNHCR, IOM, OBSH, UNWOMEN dhe ILO parashikojnë nga 5 deri në 10 milion dollarë financim të nevojshëm. Në fund, UNFPA, UNODC, UNIDO, UNESCO, UN HABITAT, UNECE, UNDRR dhe OHCHR parashikojnë 5 milion dollarë ose më pak mjete të nevojshme për agjenci. Kjo i reflekton llojet e ndryshme dhe modalitetet e mbështetjes të ofruara nga agjencitë e ndryshme, ku pjesa më e madhe e tyre për siguron mbështetje përmes "masave të buta" d.m.th. këshilla rreth politikave, avokim dhe ndërtim të kapaciteteve, ndërsa më pak agjenci i kombinojnë "masat e buta" me burime më investive dhe implementim.

Modelet e financimit

Mund të merren në konsideratë opsionet për të kaluar më shumë drejt financimit më të pacaktuar ose të bashkuar, me qëllim të përmirësimit të kombinimit të modalitetit të financimit. Midis fondeve që aktualisht janë në dispozicion, përzierja e modalitetit të financimit është e anuar kah financimi i bazuar në projekt (34.9 milion dollarë), e ndjekur nga fondi bazë (14.5 milion dollarë) dhe financimi i bashkuar dhe vertikal (10.9 milion dollarë). Proporcionet nga modalitetet tjera të financimit janë dukshëm më të vogla (financimi i qeverisë, 2.9 milion dollarë; fonde tematike, 1.4 milion dollarë) ose shuma tejet të vogla (financimi i sektorit privat, 0.02 milion dollarë). Mbështetja e lartë në financimin specifik të projektit sinjalizon një përzierje të modalitetit të financimit nën nivelin optimal, që përmban shumë ndihma të përcaktuara fuqishëm, që e rrit koston e transaksionit dhe e zvogëlon potencialin që ekipi i OKB-së të sigurojë mbështetje më të gjerë dhe më koherente për qeverinë.

Në përputhje me angazhimet e saja për transparencë dhe përgjegjësi, OKB-ja do t'i azhurnojë rregullisht të dhënat e Kornizës së Financimit gjatë periudhës së implementimit të KBZhQ-së.



Në fokus përgatitja për vaksinat për COVID-19

Maqedonia e Veriut filloi me vaksinimin për COVID-19

Më 17 shkurt të këtij viti Maqedonia e Veriut e filloi fazën e parë të vaksinimit për COVID-19 në përputhje me planin e saj nacional për vaksinim, i cili i jep përparësi vaksinimit për punonjësit shëndetësor, qytetarët profesionistë dhe cilëve i vë ata në rrezik të veçantë nga infektimi me COVID-19.

Administrimi i vaksinës varet nga situata epidemiologjike, disponueshmëria e vaksinave COVID-19 dhe kapaciteti global i prodhuesve për prodhim të saj. Tani është në rrjedhë e sipër vaksinimi i punonjësve shëndetësorë, që drejtpërsëdrejti punojnë me pacientë të sëmurë, më pas në radhë do të jenë njerëzit e moshuar si dhe grupet me prioritet.

Jo të gjithë mund të vaksinohen menjëherë pasi sigurimi i vaksinave të mjaftueshme është i vështirë për shkak të mungesës së prodhimit dhe furnizimit. Përcaktimi i përparësive strategjike është thelbësor për të siguruar që dërgesat e para të dozave të vaksinave të kenë ndikimin më të madh të mundshëm në zvogëlimin e sëmundjeve të rënda dhe vdekjeve. Kjo nënkupton dhënien përparësi të individëve më të rrezikuar, siç janë punonjësit e kujdesit shëndetësor, që i trajtojnë pacientët me COVID-19, dhe personat e moshuar, të cilët janë në rrezik më të madh që të pësojnë më rëndë nga sëmundja. Meqenëse grupeve të popullsisë në rrezik të lartë u është dhënë përparësi, shumë kategori tjera të qytetarëve do të duhet të presin për të marrë vaksinën e tyre për COVID-19.

Plani nacional i shpërndarjes së vaksinimit do të vazhdojë të zhvillohet në javët dhe muajt e ardhshëm pasi që më shumë vakcina të ndryshme për COVID-19 do të bëhen të disponueshme në vend. Qëllimi përfundimtar është që të mbulohej të gjithë njerëzit mbi moshën 18 vjeçare.

Kuptohet që do të duhet kohë për t'i vaksinuar të gjithë për COVID-19, andaj ndërkohë duhet të vazhdojmë t'u përbahemi masave të provuara që i mbajnë të gjithë të sigurtë: distanca fizike, përdorimi i duhur i maskës dhe higjiena e duarve.

Fillimi shpresëdhënës i vaksinimit inician çështje të reja, disa prej të cilave janë adresuar më poshtë.

A janë të sigurta vaksinat COVID-19?

Për ta aprovuar përdorimin e tyre, vaksinat COVID-19 duhet t'i përbushin standardet më të larta të sigurisë dhe efikasitetit. Komuniteti global është bashkuar në një mënyrë të jashtëzakonshme, përmes investimeve të pashembullta financiare dhe bashkëpunimeve shkencore për zhvillim të vaksinave COVID-19 në një kohë rekord, madje edhe më shumë është në zhvillim e sipër. Megjithatë përshpejtimi i procesit nuk i ka bërë sistemet e testimit, vlerësimit të rezultateve dhe aprovimit të ndonjë vaccine më pak rigorozë. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) po e monitoron me kujdes shpërndarjen e të gjitha vaksinave COVID-19, përfshirë monitorimin e ngjarjeve të sigurisë.

A mund t'i rikthehem jetës normale pasi të vaksinohem?

Zhvillimi kryesor në përgjigjen ndaj pandemisë është disponueshmëria e vaksinave të sigurta dhe efektive. Ndikimi i mundshëm i vaksinave për të na ndihmuar t'i japim fund kësaj pandemie do të kërkojë kohë. Në fakt kjo do të mund të realizohet vetëm nëse shumica dërrmuese e njerëzve bashkohen në këtë përpjekje dhe vaksinohen. Rikthimi në gjendje normale nuk do të varet nga aftësia jonë për ta eliminuar ose jo sëmundjen në disa zona, por nga pamundësia e përcjelljes së sëmundjes përmes të gjithë kufijve tanë. Ne jemi të sigurt vetëm kur të gjithë janë të sigurt.

Vaksinat COVID-19 i përmirësojnë ndjeshëm masat që tashmë i kemi në dispozicion për ta luftuar këtë sëmundje, por ato nuk janë të mjaftueshme për ta penguar transmetimin. Prandaj



Vaccine preparation. Photo credit @UNICEF/2020/Georgiev

ato nuk do ta zëvendësojnë përdorimin e maskave, mbajtjen e distancës dhe higjienën e duarve në të ardhmen e afërt. Ndonëse vaksinimi shënon progres, ne megjithatë nuk duhet ta lejojmë ta zbrisim nivelin e kujdesit, pasi kjo mund të bëhet shkas për përhapjen e virusit në një komunitet më të gjerë.

KOVID-19 përballë mitit dhe shkencës

Në internet dhe anekënd mediave sociale qarkullojnë shumë dezinformata dhe mite në lidhje me COVID-19 dhe vaksinat.

Për këtë arsye me rëndësi është t'i merrni informacionet dhe këshillat nga burimet e besueshme. Një burim i tillë i besueshëm është [HealthBuddy+](#), vegël e zhvilluar nga zyrat rajonale e UNICEF-it dhe OBSH-së, e disponueshme në gjuhët maqedonase dhe shqipe falë mbështetjes financiare të Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Vegla në fjalë ofron qasje në informacione të azhuruara dhe të bazuara në prova për virusin COVID-19 dhe për vaksinën COVID-19. Zbriteni aplikacionin në [Apple](#) dhe [Google Play](#) për të komunikuar me çatbot, për t'i raportuar thashetheme dhe për të marrë pjesë në hulumtime dhe sondazhe – gjithçka është në dorën tuaj.

Kohëve të fundit Qendra për Bashkëpunim e OBSH-së për Sigurinë e Vaksinave e publikoi një ueb faqe për vaksinën COVID-19, ku ofroi shpjegim të vaksinimit, që ofron video dhe podkaste për punonjësit shëndetësorë dhe publikun, me qëllim të adresimit të pyetjeve të zakonshme në lidhje me vaksinat COVID-19 ([gjendet këtu](#)).

Source UNICEF

QUICK LINKS



COVID-19 mite dhe fakte për vaksinat

“Science in 5” (Shkenca në 5) është një video dhe podkast seri, e cila i reflekton bisedimet rreth shkencës. Ekspertët e OBSH-së i shpjegojnë faktet shkencore në lidhje me COVID-19 në çdo episod pesëminutësh. ([gjendet këtu](#))

Shihni [këtu](#) udhëheqësin kryesor shkencor të OBSH-së, duke e shpjeguar vaksinën COVID-19 në lidhje me pyetjet në fushën e shkencës nga 12 shkurti i vitit 2021.

Source WHO

The latest version of the Sustainable Development Bulletin is available on UN North Macedonia website. For additional information, please contact rc-northmacedonia@un.org. Produced by the UN Resident Coordinator's Office in North Macedonia | 8 March 2021

www.un.mk